

OLGA TOKARCZUK

KALOJE PLUGUN MBI KOCKAT E TË VDEKURVE

E përktheu nga polonishtja
ASTRIT BEQIRAJ

Përmbajtja

1. Dhe tani bëni kujdes!	5
2. Autizmi testosteronian	24
3. Dritësia e Përjetshme	43
4. 999 vdekje	55
5. Dritë në shi	73
6. Vogëlsi dhe banalitete	94
7. Fjalim për Qenin Pudëll	110
8. Urani në shenjën e Luanit	127
9. E madhja në të voglën	151
10. Cucujus Haematodes	164
11. Kënga e Lakuriqëve të natës	178
12. Çupakabra	198
13. Harkëtari i natës	212
14. Rënia	230
15. Shën Hubertus	246
16. Fotografia	272
17. Virgjëresha	286

1. Dhe tani bëni kujdes!

*“Njëherë, pasi mori një rrugë të rrezikshme,
Njeriu i drejtë vazhdoi udhën i përunjur
nëpër Luginën e vdekjes”.*

Tashmë jam në një moshë, për më tepër, në një gjendje të tillë që para gjumit më duhet përherë të laj siç duhet këmbët, me idenë për të qenë gati në rast se vjen urgjenca Natën për të më marrë.

Nëqoftëse asaj mbrëmjeje do të kisha kontrolluar tek “Efemeridet” atë që ndodhte në qiell, nuk do të kisha shkuar fare të flija. Ndërkaq, po bëja një gjumë shumë rëndë; kisha pirë një çaj kulpre të butë, të cilit i kisha shtuar edhe dy tableta valerian. Kështu që kur u zgjova në mes të Natës nga trokitja e derës - e furishme, e fortë, ndaj edhe kobndjellëse - nuk po mundesha të mblidhja veten. Brofa dhe ndenja pranë shtratit, e pasigurt, ngaqë trupi i pangopur me gjumë dhe i telikosur nuk po mundej të hidhej nga pafajësia e ëndrrës në realitet. U ndjeva e dobët dhe po më merreshin mendtë, sikur pas pak do të humbisja ndjenjat. Më ndodh kjo, për fat të keq, kohëve të fundit dhe ka lidhje me problemet e mia shëndetësore. M'u desh të ulesha dhe të përsëritja me vete disa herë: jam në shtëpi, është Natë, dikush po troket; vetëm pas kësaj arrita të mposhtja nervozizmin. Teksa po kërkoja në errësirë shapkat, dëgjoja që ai që kishte trokitur, tani po i sillej shtëpisë vërdallë duke mërmëritur. Poshtë, në kthinën e matësave elektrikë, kam një spraj me gaz paralizues që ia kam marrë Dionisit për t'u mbrojtur nga gjahtarët e paligjshëm, dhe bash për të po mendoja. Arrita gjithsesi të gjeja në errësirë formën e njohur e të ftohtë të bombolës me aeroxol, dhe e armatosur kësisoj, ndeza llambën e jashtme. Pashë përjashta në verandë përmes dritares anësore. Bora kërciste dhe në fushëpamjen e shikimit tim u shfaq komshiu, të cilit i kam vënë nofkën Zevzeku. Ishte mbështjellë me atë xhupin e vjetër prej lëkure deleje, me të cilin e kisha parë ndonjëherë të veshur kur punonte përreth shtëpisë. Nga poshtë xhupit i dilnin këmbët me një palë pizhame me vija dhe këpucët e rënda nga ato për të ecur në mal.

- Hape, - tha.

Me një habi të pafshehur i hodhi një sy kostumit tim veror prej linoje (kur fle mbaj veshur rrobën që Profesori me të shoqen donin ta hidhnin verës që shkoi, e cila mua më kujton modën e shkuar të viteve të rinisë - kombinoj kësisoj të Dobishmen me Sentimentalen) dhe hyri pa teklif brenda.

- Vishu, të lutem, ka vdekur Shputëmadhi.

Nga befasia për një çast më iku goja; ngjeshja pa bëzajtur çizmet e gjata të borës dhe hodha supeve trikon e parë që më zuri dora në dollap. Përjashta, te pellgu i ndriçuar që formonte drita që binte nga llamba e verandës, dëborë po shndërrohej në një dush të ngadaltë e të përgjumur. Zevzeku po më rrinte pranë në heshtje, i gjatë, i dobët, eshtak, si një figurë e skicuar me disa të rëna lapsi. Në çdo lëvizje i binte nga trupi dëborë njëllor si tek mafishet pudrosur me sheqer.

- Ç'do të thuash“ ka vdekur?” - e pyeta më në fund, duke ndjerë një shtrëngim në fytyrë, teksa hapa derën, por Zevzeku nuk u përgjigj.

Ai në përgjithësi flet pak. Me siguri ka Mërkurin në shenjën e heshtjes, gjykoj se do jetë i shenjës së Bricjapit në të njëjtën linjë, te briri i hënës, apo ndoshta në të kundërt me Saturnin.

Por, fare mirë mund të jetë edhe Merkuri në lëvizje prapa, që po ashtu, sjell një natyrë të rezervuar.

Me të dalë nga shtëpia na përfshiu ajri i ftohtë dhe i lagësht, për ne i njohur, dhe që çdo dimër na kujtonte se bota nuk ishte krijuar për Njeriun dhe që, së paku për gjashtë muaj të vitit, na dëshmon se sa armiqësore është natyra me ne. Acari na sulmoi brutalisht faqet, teksa nga goja na dilnin re të bardha avulli. Llamba e verandës u fik automatikisht dhe ne morëm udhën përmes borës që kërciste në mes të një errësire të plotë, nëse nuk llogarisim në fakt dritën e llambës që Zevzeku mbante te balli, e cila shponte errësirën duke formuar një pikë të ndriçuar që zhvendosej bash para tij. Unë shkelja në Terr pas shpinës së tij.

- Nuk ke ndonjë elektrik dore? - pyeti.

Po, kisha, po ku? Këtë do mund ta mësoja vetëm të nesërmen në mëngjes, në dritën e diellit. Gjithmonë kështu ndodh me elektrikët e dorës, i sheh vetëm me ditë.

Shtëpia e Shputëmadhit ishte disi e mënjanuar, disi më lartë se shtëpitë e tjera. Ishte njëra nga tre shtëpitë që banohej gjatë gjithë vitit. Vetëm ai, Zevzeku dhe unë banonim këtu, pa iu trembur dimrit - të tjerët i mbyllnin e u vinin drynin shtëpive qysh në tetor, pasi kishin boshatisur më parë tubat nga uji, duke u kthyer në qytet.

Tani dolëm nga rruga e pastruar disi nga bora, e cila përshkonte lagjen tonë, duke u ndarë nëpër shtigje të cilët të shpien në çdo shtëpi. Shtegu i hapur mes dëborës së thellë që të çonte tek Shputëmadhi, vinte aq i ngushtë sa që hapat duheshin hedhur kujdesshëm njëri pas tjetrit, duke u përprjekur të mbaje vazhdimisht ekuilibrin.

- Nuk do të jetë pamje e këndshme, - më paralajmëroi Zevzeku, dhe duke u kthyer nga unë, më verboi për një çast krejtësisht me atë llambën e tij.

Nuk e prisja ndryshe. Heshti një hop e pastaj sikur donte të shpjegohej, tha:

- Më shqetësoi drita në kuzhinën e tij dhe qeni që po lehte me një ton aq të përvajshëm. Nuk ke dëgjuar gjë?

Jo, nuk kisha dëgjuar asgjë. Isha në gjumë, e trullosur nga kulpra dhe nga valeriani.

- Po Qeni, ku është tani?

- E hoqa prej andej, e mora me vete, e ushqeva dhe besoj do jetë qetësuar.

Sërish një çast heshtjeje.

- Ai gjithmonë binte të flinte herët dhe fikte dritën, kursente, ndërsa kësaj here ajo vazhdonte të ishte e ndezur. Një fashë e ndritshme përmbi dëborë. Shihej nga dritarja e dhomës sime të gjumit. Kështu që shkova të shihja dhe po mendoja se mos ndoshta ishte i dehur, apo po i bënte ndonjë gjë qenit që po ulërinte ashtu.

Kaluam një stallë të rrënuar dhe një çast më pas feneri i Zevzekut qëmtoi në terr dy palë sy të shndritshëm, në një të gjelbër të zbehtë, fluoreshentë.

- Pa shih, kaproj, - mërmërita e eksituar dhe e kapa atë nga mënga e xhupit. - Paskan ardhur kaq afër shtëpisë. Nuk kanë frikë?

Kaprotë ishin të zhytur në borë pothuajse deri në bark. Po na vështronin qetësisht, a thua se ne i kishim gjetur përgjatë kryerjes së ndonjë rituali, kuptimin e të cilit nuk mund ta merrnim vesh. Ishte errësirë kështu që nuk mund të dalloja nëse ishin po ato Zonjushat që në vjeshtë kishin ardhur nga Çekia, apo ishin të tjera? Dhe përse pikërisht vetëm dy? Ato të mëparshmet kishin qenë së paku katër.

- Shkoni në shtëpi - u thashë kaprojevë, dhe nisa të tundja krahët. Ato kapsallitën sytë, por megjithatë nuk lëvizën vendit. Na shoqëruan paqësisht me sy derisa mbërritëm tek dera. Më shkuan mornica nëpër trup.

Zevzeku ndërkaq po shkundte këpucët nga bora para portës së shtëpisë së shkalafitur. Dritaret e vogla ishin të mbuluara me plastmas dhe me letër, dera prej druri me katrama të zezë.

Muret e hajatit ishin dingas me dru zjarri, të vendosur në stivë jo të rregullt. Brenda ishte një pamje e pakëndshme, s'ke çfarë thua. E pistë dhe si mos më keq. Gjithandej ndihej aroma e lagështisë, e druve dhe e dheut të lagur. Bloza, shumëvjeçare, ishte ngjitur mureve me një shtresë veshulllore.

Dera e kuzhinës ishte e hapur përgjysmë kështu që menjëherë pashë trupin e Shputëmadhrit që dergjej në dysheme. Shikimi im sa e fshiku për t'u tërhequr pas menjëherë. Kaluan disa çaste para se të mund të shihja sërish nga ajo anë. Ishte një pamje e tmerrshme.

Ai Dergjej i spërdredhur në një pozicion të çuditshëm, me duart rreth qafës, sikur të përpiqej të hiqte një jakë që po i merrte frymën. Po i avitesha ngadalë si e hipnotizuar. Pashë se si sytë e hapur i kishte ngulitur te një pikë diku nën tryezë. Fanella e pistë ishte e grisur përreth fytit. Dukej sikur trupi kishte luftuar me vetveten dhe i mundur - ishte dorëzuar. M'u ngjeth mishtë nga Tmerri, më ngriu gjaku në damarë dhe pata përshtypjen se ishte tërhequr diku në thellinat e trupit tim. Vetëm një natë më parë e kisha parë këtë trup të gjallë.

- O Zot, - belbëzova. - Ç'ka bërë vaki?

Zevzeku ngriti supet.

- E kam të pamundur t'i telefonoj Policisë, përsëri s'ka valë.

Nxora nga xhepi telefonin celular, formova numrin që e kisha mësuar nga televizioni - 997, dhe pas një çasti në aparatim tim u dëgjua një zë i regjistruar në çekisht. Këtu kështu është. Valët shtegtojnë pa pyetur fare për kufirin e shteteve. Ndonjëherë kufiri midis operatorëve ndalet për një kohë të gjatë në kuzhinën time, ka ndodhur edhe që ka qenë për disa ditë pranë shtëpisë së Zevzekut ose në verandë, por sidoqoftë ishte gjithnjë e vështirë ta parashikoje karakterin e tyre kapriçioz.

- Duhet ngjitur diku lart në kodrinë, - e këshillova pas një copë here.

- Para se të mbërrijnë ata, ai do të ketë ngrirë tërësisht, - tha Zevzeku me atë tonin që s'më pëlqente fare, prej njeriu që i është mbushur mendja se i di të gjitha. Hoqi xhupin dhe e vari në shpinoren e një karrigeje. - Nuk na falet ta lëmë në këtë gjendje. Duket një tmerr, në fund të fundit ka qenë fqinji ynë.

Po kundroja trupin e gjerë, të mbledhur kruspull të Shputëmadhrit dhe e kisha të vështirë të besoja se deri një natë më parë kisha patur frikë nga ky Njeri. Nuk e kisha qejf. Madje kjo që thashë më duket shumë pak - nuk e duroja dot. Më duhet të them më tepër - më dukej i neveritshëm, i llahtarshëm. Ç'është e vërteta nuk e shihja as edhe si një Qenie njerëzore. Dhe ja tani ku dergjej në dyshemenë plot me njolla, me fanellën të fëlliqur, ashtu i zvogëluar dhe i tharë, i pafuqi dhe krejt i parrezikshëm. Ja, një copë materie, e cila për shkak transformimesh vështirë të imagjinueshme, ishte kthyer në një qenie të brishtë, të ndarë nga gjithçka tjetër. Ndieja përbrenda një trishtim sflitës, sepse edhe një qenie aq e neveritshme si ai, fundja, prapë nuk e meritonte të vdiste kështu. Por kush e meritonte atëherë? Edhe mua më priste i njëjti fat, edhe Zevzekun, edhe ata Kaproj që ishin atje përjashta, të gjithë një ditë nuk do të jemi veçse kufoma.

Pashë nga Zevzeku, me shpresë se mos gjeja tek ai ndonjë ngushëllim, mirëpo ai po merrej me sistemimin e krevatit rrëmujë, si dhe me pastrimin e pisllëkut në divan, ndaj provova të gjeja ngushëllim te mendimet e mia. Më shkrepri atë çast në kokë se vdekja e Shputëmadhit mund të kishte qenë në njëfarë kuptimi diçka e mirë. E kishte liruar atë nga ai kaos që kishte qenë e gjithë jeta e tij. Dhe kishte shpëtuar njëkohësisht prej tij Qeniet e tjera të gjalla. Po, kështu, befasisht kuptova se sa e mirë mund të jetë vdekja, sa e drejtë, një lloj dezinfektuesi, një lloj fshese me korrent. E pranoj, kjo është ajo që mendova atë çast dhe, që të them të vërtetën, vijoje ta mendoj.

Ishte komshiu im, shtëpitë tona ishin jo më shumë se gjysmë kilometri larg njëra-tjetrës, e megjithatë rrallë kisha pasur të bëja me Shputëmadhin. Fatmirësisht. E kisha parë më tepër nga larg - figura e tij e imët, e thatë, përherë disi e paqëndrueshme, që zhvendosej në sfondin e peizazhit. Në ecje diç i murmuriste vetes dhe kohë pas kohe akustika ajrore e Pllajës më përcillte copëza të këtij monologu, në thelb të thjeshtë dhe monoton. Fjalori i tij përbëhej kryesisht nga mallkime, të cilave u ngjiste emra të përveçëm.

Njihte çdo pëllëmbë toke ngase, me gjasë, këtu kishte lindur dhe nuk kishte bërë tutje më larg se deri në Klloxkë. E njihte pyllin - dinte me çka mund të bëje pará, duke e shitur. Kërpudha, boronicë, dru të vjedhur, bujashka, leqe, garat e përvitshme me fuoristrada, gjuetia. Pylli e pat mbajtur gjallë këtë lugat. Pylli, pra, ai duhej ta respektonte, gjë që ai nuk e bënte. Një herë, në gusht, kur kishte bërë thatësi, i kishte vënë flakën gjithë fushës me boronicë. Telefonova atëbotë shërbimin zjarrfikës, nuk u shpëtua megjithatë ndonjë gjë e madhe. Nuk e mora vesh kurrë përse e kishte bërë. Verës bridhte nëpër mëhallë me sharrën në dorë dhe priste pemë plot me lëngësi. Kur i tërhoqa njëherë vëmendjen gjithë mirësjellje, me një zemërim të frenuar me zor, m'u përgjigj thjesht me një: "Ik moj pirdhu, plakaruqe". Në fakt, edhe një çik më shkoqur sesa kaq. Fitonte ngaqë përherë diçka vidhte, zhvaste, mashtronte - sa herë që pushuesit verorë harronin ndonjë fener apo gërshërë, Shputëmadhi e nuhaste menjëherë rastin dhe përlante çdo gjë që më pas do mund të shkonte për ta shitur në qytet. Sipas meje e kishte bërë hak disa herë për t'u gjobitur, pse jo edhe të shkonte në burg. Nuk di çfarë ndodhte që gjithçka atij i shkonte fjollë. Ndoshta e ruante ndonjë engjëll, ndonjëherë edhe kjo bën vaki, që engjëjt të mos jenë në anën e duhur.

Dija gjithashtu se gjuante ilegalisht me të gjitha mënyrat e mundshme. Pyllin e trajtonte si bahçen e vet - gjithçka i takonte atij. Ishte tipi i cubit.

Ai më kishte bërë të kaloja kushedi se sa Netë pa gjumë, kur rrija shtrirë pa mbyllur dot sy ngaqë s'dija ç'të bëja nga pafuqia. I telefonova disa herë Policisë, që edhe kur ma ngrinin telefonin, mbanin shënim mirësjellshëm denoncimin tim, por paskësaj nuk ndodhte kurrëgjë. Shputëmadhi vazhdonte të sillej vërdallë me avazin e vet, me një barrë leqesh në krah, duke lëshuar klithma ndjellakeqe. Një Shpirt i vogël, i keq. Dashakeq dhe i paparashikueshëm. Ishte përherë ngapak i dehur dhe ndoshta kjo e bënte të kishte gjithmonë një humor të tillë malinj. Mërmëriste me vete duke i goditur me një shkop trungjet e pemëve, si të donte t'i zhdukte nga rruga e tij; dukej se që kur kishte lindur ishte gjithmonë në një gjendje të lehtë dehjeje. Kam ecur shpesh pas gjurmëve të tij, duke mbledhur çarqet primitive të bëra me tel hekuri për Kafshë, leqe në pemë të reja të përthyer, të lidhur në mënyrë të tillë që Kafsha e kapur të fluturonte si e hedhur me ndonjë hobe, dhe të mbetej e varur në ajër. Gjeja ndonjëherë Kafshë të ngordhura - Lepuj, Baldosa dhe Drerë.

- Duhet ta shtrijmë mbi divan, - tha Zevzeku.

Nuk më pëlqeu kjo ide. Nuk më pëlqente ideja që do më duhej ta prekja.

- Mendoj se duhet të presim Policinë, - thashë. Mirëpo Zevzeku kishte bërë ndërkaq gati vendin në divan dhe kishte përveshur mëngët e bluzës. Po më zhbirilonte thekshëm me ata sytë e tij të çelët.

- Ma ha mendja se as ti s'do të doje që të të gjenin kështu. Në këtë gjendje. Është çnjerëzore.

Ah po, me siguri trupi i njeriut është diçka jonjerëzore. Veçanërisht kur ka vdekur.

A nuk është një paradoks kobzi që tani na duhet të merremi me trupin e Shputëmadhit, që na e la peshqesh edhe këtë barrë të fundit? Neve, fqinjëve, që nuk na respektonte, nuk na donte dhe nuk na llogariste fare.

Sipas meje, Vdekja do duhet të pasohet nga zhbërja e materies. Do të ishte zgjidhja më e mirë për trupin. Trupat e zhbërë do të ktheheshin kësisoj drejt e tek vrimat e errëta prej nga vinin. Ndërsa Shpirtrat do të shtegtonin me shpejtësinë e dritës për tek drita. Natyrisht, nëqoftëse diçka e tillë si Shpirti ekziston.